



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 03.nëntor 2011

Nr. ref.: RK161/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Në

Rastin Nr. KI 113/10

Parashtruesi

Ilmi Rakovica

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë,
P.nr. 529/06, të 15 marsit 2007,
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pp.nr. 200/07, të 5 korrikut 2007,
dhe
Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr. 465/07, të 12 dhjetorit
2008.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkola, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Ilmi Rakovica, me adresë në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr. 529/06, i 15 marsit 2007, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pp.nr. 200/07, i 5 korrikut 2007, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr. 465/07, i 12 dhjetorit 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi mendon që i janë shkelur të drejtat e tij themelore, të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
4. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) ta rikthejë rastin e tij për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, duke pretenduar që këto aktgjykime kanë vendosur në dëm të tij dhe ia kanë shkelur të drejtat e tij themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën për të Drejtat Themelore të Njeriut.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese më 5 tetor 2010.
7. Me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese gjyqtarja Iliriana Islami u caktua Gjyqtare raportuese, dhe ai e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Gjykata e shqyrtoi kërkesën në seancë të mbyllur më 23 maj 2011.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 15 mars 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin P.nr. 529/2006, e kishte shpallur parashtruesin fajtor për tentimvrasje të rëndë të një polici, Valdet Bajrami, dhe e kishte liruar nga akuza për tentimvrasje të rëndë të një polici tjetër, Faruk Hoxha. Ai gjithashtu ishte shpallur fajtor për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Pasi që ishte shpallur fajtor, parashtruesit i ishte shqiptuar dënimi unik me 3 vjet burg.
10. Më 5 korrik 2007, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ap.nr. 200/07, e hodhi poshtë si të pabazë ankesën e parashtruesit. Gjykata e rishikoi një pjesë të vendimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, P.nr. 529/2006, lidhur me kohëzgjatjen e dënimit për akuzën për vrasje të rëndë dhe e rriti dënimin në tri vjet e gjashtë muaj burg. Gjykata, gjithashtu ia dërgoi për rigjykim Gjykatës së Qarkut një pjesë të vendimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, P.nr. 529/2006, lidhur me lirimin nga akuza për tentimvrasje të rëndë të Faruk Hoxhës. Gjykata e vërtetoi dënimin me burg prej një viti për mbajtje apo shfrytëzim të armëve dhe shqiptoi dënimin unik me katër vjet burg.
11. Më 12 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin P.nr. 465/07, e shpalli parashtruesin fajtor për tentimvrasje të rëndë të Faruk Hoxhës dhe ia shqiptoi dënimin unik me katër vjet e gjashtë muaj burg.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi mendon që është akuzuar për një vepër penale të cilën nuk e ka kryer. Ai gjithashtu ankohet që gjatë kontrollimit në banesën e tij policia përdori armë dhe dhunë të tepërt fizike, e lëndoi, e rrahu dhe e torturoi.
13. Si rrjedhojë, parashtruesi pretendon që të drejtat e tij themelore, të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës janë shkelur. Neni 23 thotë:

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

14. Parashtruesi theksoi që arsyeja pse ai nuk kishte ushtruar ankesë kundër vendimit të dytë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ishte se frikësohej që Gjykata Supreme do të mund t'ia rriste dënimin.
15. Pas leximit të tërësishëm të kërkesës së parashtruar nga parashtruesi, ajo që lihet të kuptohet është që parashtruesit nuk i ishte mundësuar gjykim i drejtë dhe i paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore. Megjithatë, kjo nuk mbrohet në mënyrë specifike as nuk është e bazuar në asnjë dokument të paraqitur me kërkesë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
17. Neni 49 i Ligjit thotë me sa vijon:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht”.

18. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P.nr. 465/07) ishte nxjerrë më 12 dhjetor 2008 dhe parashtruesit i ishte dorëzuar më 10 mars 2009. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese më 5 tetor 2010. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit prej katër muajve në përputhje me nenin 49 të Ligjit.
19. Edhe po të ishte dorëzuar kërkesa brenda afatit të paraparë me Ligj, çështja e shterimit të të gjitha mjeteve juridike duhet të trajtohet. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenin 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

“113.7 Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

“47.2 Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, përkundër këshillës së Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 12 dhjetorit 2008, se ai mund t'i drejtohet Gjykatës

Supreme të Kosovës me një ankesë kundër aktgjykimit të saj, ai nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë juridike.

21. Gjykata, gjithashtu vëren që dyshimi i thjeshtë për perspektivën e çështjes nuk mjafton për ta përjashtuar parashtruesin nga detyrimet e tij për t'u ankuar në organet kompetente (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 7 marsit 1994, Kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f.80).
22. Më parë, Gjykata theksoi se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803194, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679100, Vendim i 28 prillit 2004).
23. Gjykata e zbatoi të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri më 27 janar 2010 për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në Rastin Nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në vendimin e vet të 23 marsit 2010 në Rastin Nr. KI. 73/09, Mimoza Kusari Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.
24. Prandaj, Gjykata vlerëson që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit.

PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Iliriana Islami



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani